

# REAGIM PËR MEDIAN

**Tiranë, më 29 Maj 2026:** Në lidhje me artikullin e publikuar nga [Vna.al](http://Vna.al) dhe disa media të tjera mbi Raportin Vjetor 2025 të INSTAT, sqarojmë se interpretimet që e paraqesin procesin e transmetimit të Statistikave Financiare të Qeverisë (GFS) dhe të Procedurës së Deficitit të Tejskajshëm (EDP) si “fshehje të të dhënave” nuk mbështeten në përmbajtjen e raportit dhe nuk pasqyrojnë natyrën metodologjike të procesit statistikor.

Raporti Vjetor 2025 evidenton progresin e arritur në harmonizimin e statistikave shqiptare me standardet e Eurostat-it. Për herë të parë, gjatë vitit 2025, INSTAT transmetoi në Eurostat të dhënat për periudhën 2021–2024 me statusin “For Publication”, një zhvillim që përfaqëson avancim në procesin e integritetit evropian dhe jo mungesë transparence.

Statuset teknike të përdorura nga Eurostat për publikimin e të dhënave lidhen me procedurat e validimit, kontrollit të cilësisë dhe verifikimit metodologjik dhe nuk nënkuptojnë mosdisponueshmëri apo fshehje të informacionit.

Gjithashtu, krahasimet mbi numrin e takimeve institucionale duhet të lexohen në kontekstin e realizimit të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023, një operacion statistikor i jashtëzakonshëm që kërkoi angazhim dhe koordinim shumë më të lartë se aktiviteti i zakonshëm institucional. Për rrjedhojë, ndryshimet në numrin e takimeve ndërmjet viteve nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht rënie të aktivitetit apo performancës institucionale.

INSTAT mbetet i angazhuar për prodhimin e statistikave zyrtare të pavarura, transparente dhe të besueshme, në përputhje me Ligjin për Statistikat Zyrtare, Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane dhe standardet e Sistemit Evropian të Statistikave.

**Ftojme median dhe publikun t'u referohen dokumenteve zyrtare dhe shpjegimeve metodologjike për interpretimin e saktë të proceseve të prodhimit të statistikave zyrtare, të cilat janë realizuar në përputhje me standardet evropiane.**